

FUSHA E AKTIVITETIT: NJOHJA E VETËS DHE E BOTËS

Grup mosha 5-6 vjeçare

Fondi javor: 2 orë

Fondi vjetor: 74 orë

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME PËR GRUP MOSHAT 5- 6 VITE

1. Të zhvillohet kërkuesia për njohjen e vetes dhe botës.
2. Ta njohë veten. Kush jam dhe çfarë mund të bëjë.
3. Të zhvillohet siguria, pavarësia në shprehje dhe sjellje- autonomia e personalitetit.
4. Të njohë, të vendosë dhe të forcojë relacionet dhe komunikimin në mjedisin jetësor (social e të tjerë).
5. Të njohë nevojën dhe mundësinë e mbrojtjes dhe të shkathtësohet ta mbrojë veten dhe të tjerët.
6. Të mësohet të vlerësojë dhe të respektojë mjedisin jetësor (botën e gjallë dhe jo të gjallë).
7. Ta zhvillojë ndjenjën se i përket mjedisit jetësor.
8. T'i njohë, t'i vlerësojë dhe t'i respektojë mjediset e kulturat tjera ndryshe nga vetja.
9. Të zhvillohen aftësitë krijuese.
10. Të zhvillohet sensi për vetëkritikë dhe kritikë.

PLANI-PROGRAMI VJETOR I AKTIVITETEVE

TËRSITË PROGRAMORE TË AKTIVITETEVE

	Fondi i orëve
1. Njohja e vetvetes dhe të kuptuarit e identitetit personal dhe mjedisit social	12
2. Njohja dhe të kuptuarit e varësive reciproke të mjedisit jetësor	10
3. Njohja dhe të kuptuarit e sjelljeve të praanueshme në mjedisin jetësor dhe sjellja e fëmijëve konformë tyre	12
4. Njohja dhe të kuptuarit e të drejtave personale dhe të tjerëve , si dhe respektimi i tyre	8
5. Kujdesi, mbrojtja dhe kultivimi i mjedisit jetësor	8
6. Rujatja dhe kujdesi për botën bimore dhe shtazore dhe kultivimi i saj	10
7. Rujatja, kujdesi dhe shprehitë e higjienës personale, kultivimi i ambientit të sjelljeve të- kulturuara dhe të punës	14
	74 orë

PLAN-PROGRAMI MUJOR I AKTIVITETEVE

Muaji	Ora	Aktivitetit mujore
Shtator	1.	Aktivitetet e vëzhgimit të veprimtarive të trupit të fëmijës
	2.	Perceptimi i shprehjes së fëmijës në detyrat personale
	3.	Shëtitje në natyrë - njohja e ndryshimeve atmosferike dhe veçorive të tjera të stinës së verës
	4.	Pjesët e trupit të fëmijës
	5.	Funksionimi i organeve të trupit të fëmijës gjatë realizimit të veprimeve konkrete
	6.	Punimi i kalendarit vjetor dhe fillimi i paraqitjeve grafike të ngjarjeve dhe fenomeneve natyrore në të
	7.	Biseda për shkathtësitë dhe ngathtësitë e trupit të fëmijës në veprimtari të caktuara
	8.	Aktivitetet e veçanta praktike për ushtrimin e ndijimit të të prekurit dhe përshkrimi në mënyrë verbale çfarë kanë hetuar
Tetor	1.	Aktivitetet e veçanta praktike për ushtrimin e ndijimit të të parit dhe përshkrimi në mënyrë verbale çfarë kanë hetuar
	2.	Aktivitetet e veçanta praktike për ushtrimin e ndijimit të nuhatjes dhe përshkrimi në mënyrë verbale çfarë kanë hetuar
	3.	Konstruktimi me materiale të llojllojshme dhe krijimi i produkteve nga të cilat fitohet

		vetëbesimi në të arriturat
	4.	Aktivitetet komplekse të cilat kërkojnë kohë dhe qëndrueshmëti më të fortë për t'i realizuar ato
	5.	Biseda për përjetimet e fëmijëve gjatë organizimit të aktiviteteve të ndryshme dhe identifikimi i emocioneve të këndshme dhe ato të pakëndshme
	6.	Organizimi i aktiviteteve të ndryshme dhe komunikimi për përparsitë dhe dobësitë personale
	7.	Shëtitje në natyrë - njohja e ndryshimeve atmosferike dhe veçorive të tjera të stinës së vjeshtës
	8.	Zhvillimi i aktiviteteve si pyetje - përgjigje në tema të cilat kanë interes fëmijët
Nëntor	1.	Aktivitetet për luajtjen e roleve pa dallim gjinor dhe shfrytëzimi i shkathësive adekuate sociale
	2.	Luajtja e lojërave të ndryshme simbolike në të cilat modelon sjellje dhe veprime mbi bazën personave dhe personazheve pozitivë
	3.	Aktivitetet e preventivës për ruajtjen e shëndetit - mënyra e të ushqyerit të shëndoshë
	4.	Aktivitetet e preventivës për ruajtjen e shëndetit - nevojat fiziologjike
	5.	Aktivitetet e preventivës për ruajtjen e shëndetit - mbrojtja nga infektimet
	6.	Aktivitetet për zgjerimin e njohurive për historinë e njerëzimit
	7.	Aktivitetet për zgjerimin e njohurive për kulturën e popullit të vet
	8.	Përgatitja për kremtave të ndryshme: Festa e Flamirit, Viti i Ri, ditëlindjet etj.
Dhjetor	1.	Aktivitetet për zgjerimin e njohurive për kulturën e popujve të tjerë
	2.	Vizitë qytetit/fshatit
	3.	Vizitë teatrit (të qytetit)
	4.	Vizita e bibliotekës së qytetit
	5.	Vizita e postës së qytetit
	6.	Vizita e komuniteteve të tjera me të cilat fëmijët janë njohur përmes librave, ilustrimeve, filmit, tregimeve, përrallave etj.
Janar	1.	Biseda për familjen dhe shtëpinë e fëmijës
	2.	Biseda për familjet dhe shtëpitë e tjera
	3.	Respektimi i dallimeve në mes të kulturave të ndryshme
	4.	Tregimi i tregimeve dhe rrëfimeve nga fëmijëria e hershme
	5.	Biseda për sjelljet e përgjithshme të cilat janë afirmative për personalitetin e shëndoshë
	6.	Biseda për sfidat dhe sigurinë në botë
Shkurt	1.	Shtitje në natyrë - njohja e ndryshimeve atmosferike dhe veçorive të tjera të stinës së dimrit
	2.	Biseda për të drejtat e fëmijëve: gjinore, sociale, fetare dhe kulturore
	3.	Aktivitetet e mirëkuptimit ndaj të tjerëve
	4.	Eksperimentimi me borë dhe njohja me veçoritë e saj dhe me ndryshimet agregate të saj
	5.	Ndërmarrja e iniciativave për t'u ndihmuar anëtarëve të familjes
	6.	Ndërmarrja e iniciativave për t'u ndihmuar njerëzve në moshë
	7.	Ndërmarrja e iniciativave për t'u ndihmuar njerëzve me aftësi të kufizuara
	8.	Aktivitetet praktike përmes të cilave mësohen rregullat e sjelljes së kulturuar - respektimi i pronës
Mars	1.	Aktivitetet praktike përmes të cilave mësohen rregullat e sjelljes së kulturuar - autonomia e individit
	2.	Aktivitetet praktike përmes të cilave mësohen rregullat e sjelljes së kulturuar - ndarja e përgjegjësisë
	3.	Eksperimentimi me ajër dhe njohja me veçoritë e tij dhe me ndryshimet agregate të tij
	4.	Shëtitje në mjedise kulturore me qëllim të njohjes, analizës, kujdesit dhe të mirëmbajtjes
	5.	Vizita e kopshtit zoologjik
	6.	Vizita e mjediseve në të cilat fëmijët do të njihen me botën shtazore
	7.	Vizita e mjediseve në të cilat fëmijët do të njihen me botën bimore

	8.	Vëzhgimi i gjallesave dhe këmbimi i përshtypjeve për to
Prill	1.	Marrja e informacioneve për gjallesat nga burimet e ndryshme: TV-ja, ilustrimet, librat, filmi etj.
	2.	Modelimi i gjësendeve në bazë të modelit me mjete dhe materiale të ndryshme
	3.	Modelimi i gjësendeve në bazë të përfytyrimeve me mjete dhe materiale të ndryshme
	4.	Vizatimi i gjësendeve në bazë të modelit me mjete dhe materiale të ndryshme
	5.	Vizatimi i gjësendeve në bazë të përfytyrimeve me mjete dhe materiale të ndryshme
	6.	Modelimi i gjallesave të mjedisit jetësor në bazë të modelit me mjete dhe materiale të ndryshme
	7.	Modelimi i gjallesave të mjedisit jetësor në bazë të përfytyrimeve me mjete dhe materiale të ndryshme
	8.	Vizatimi i gjallesave të mjedisit jetësor në bazë të modelit me mjete dhe materiale të ndryshme
Maj	1.	Vizatimi i gjallesave të mjedisit jetësor në bazë të përfytyrimeve me mjete dhe materiale të ndryshme
	2.	Zhvillimi i aktiviteteve përmes të cilave kuptohet raporti shkak-pasojë dhe parashikimi i përfundimit
	3.	Vëzhgimi i ndryshimeve në mjedisin jetësor në një cikël më të gjatë kohor
	4.	Interpretimi i ngjarjeve dhe biseda me të tjerë për to
	5.	Shëtitje në natyrë - njohja e ndryshimeve atmosferike dhe veçorive të tjera të stinës së pranverës
	6.	Krahasimi i ngjarjeve dhe dukurive dhe radhitja e tyre sipas kronologjisë apo ndonjë kriteri tjetër
	7.	Vëzhgimi i dukurive natyrore - shiu, era, qielli, ylberi etj.
	8.	Majtje me njësitë jostandarde - gotë, lugë, hapa të ecjes etj
Qershor	1.	Eksperimentimi me ujë dhe njohja me veçoritë e tij dhe ndryshimet agregate të tij
	2.	Zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mësohen rregullat e protokollit
	3.	Zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mësohen doket e zakoneve tradicionale dhe qytetare
	4.	Zhvillimi i aktiviteteve përmes të cilave kuptohet varësia reciproke midis fëmijës dhe botës së gjallë dhe jo të gjallë
	5.	Konstruktimi me materiale të llojllojshme dhe njohja me veçoritë e tyre dhe vetitë e transformimit në formë dhe përmbajtje tjetër
	6.	Modelimi me materiale të llojllojshme dhe njohja me veçoritë e tyre dhe vetitë e transformimit në formë dhe përmbajtje tjetër

LINJAT KURRIKUL ARE

Përmbajtja sipas linjave:

Nxënësi do të mësohen me vëzhgimin në mënyrë të tillë që:

- Cilësitë bazë të objekteve të identifikohen nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë;
- Vëzhgimet të kryen nga pozicione të ndryshme për të pasur këndvështrime të ndryshme;

Nxënësit do të investigojë dhe të kuptojnë që qeniet njerëzore kanë shqisa, ndjesi duke përfshirë të parin, nuhatjen, dëgjim, prekje, shije. Shqisat mundësojnë të kërkosh, gjesh , të marrësh duke iu përgjigjur informacionit në mënyrë të tillë për të mësuar rreth vetes e botës që të rrethon.

Konceptet kyç përfshijnë:

- Pesë shqisat (të shijuarin, të prekin, të nuraturin, të dëgjuarin dhe të shikuarit);
- Organet e shqisave shoqërohen me organin përkatës (sytë, veshët, hunda, gjuha, dhe lëkura;
- përshkrimi i ndjesive (e ëmbla, tharta, hidhura, kripura, e ashpra e lëmuara, e fortë e butë, ftohtë, ngrohtë, I zhurmshëm – I qetë butë, I artposhtë, I ndritshëm, I turbullt

PROCESET JETËSORE

Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë nevojat bazë dhe proceset jetësore të bimëve dhe të kafshëve.

Konceptet kryesore:

- Gjallesat ndryshojnë ashtu si rriten kanë nevojë edhe për ushqim, ujë, ajër për të mbijetuar;
- Bimët dhe kafshët jetojnë dhe vdesin(fillimi e mbarimi I një cikli jetësor)
- Pasardhësit e bimëve dhe të kafshëve janë të ngjashëm por jo identik me prindërit e tyre dhe të tjerëve
- Identifikimi nëpërmjet emrit I prindit dhe pasardhësit.

NDRYSHIMET DHE CIKLI JETËSOR

Nxënësi do të hulumtoj dhe të kuptojë shembuj të thjeshtë, prototype, nga jeta e tij e përditshme

Konceptet kryesore:

- Vëzhgimi i motit;
- Format dhe përmasat e ndryshme të shumë objekteve natyrore duke përfshirë farërat, boçe, gjethet;
- Rritjen e kafshëve dhe të bimëve;
- Rutina shkollështëpi;
- Katër stinë;
- 12 muaj bëjnë vitin;
- 7 ditë bëjnë javën.

Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që ndryshimet ndodhin vazhdimisht dhe shpejtësia e tyre mund të jetë e ndryshme si:ngadalë, shpejt

Konceptet kryesore:

- sendet natyrale dhe të bëra nga dora e njeriut mund të ndryshojnë herëpas here, vazhdimisht;
- Ndryshimet mund të njihen, shikohen, dhe mund të maten.

BURIMET

Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që materialet mund ripërdoren, riciklohen, dhe të ruhen, konservohen.

Konceptet kryesore:

- Identifikim materialeve dhe objektsh që ripërdoren herë pas here;
- Përshkrimi materialeve të jetës së përditshme që riciklohen;
- Shpjegimi sesi të ruajmë ujin dhe energjinë në shtëpi dhe në shkollë.

Literatura/ Referencat

1. ABC 1+2+3 Gr.1- Metodikë libër pune, botues Ombra GVG.
2. ABC 1+2+3 Gr.2- Metodikë libër pune, botues Ombra GVG.
3. ABC 1+2+3 Gr.3- Metodikë libër pune, botues Ombra GVG.
4. Veprimtari gjuhësore: Aurela Zizi- Lefteri Selmani BK Tiranë.
5. Dituri për mua-Shtëpia botuese: Udhë e shkronjave.

Karakterisika te nxënies në këtë moshë:

- Kuptojnë që gjendja e mjedisit ndikon në shëndetin e njeriut dhe të ndjejnë nevojën e një mjedisi të shëndetshëm.
 - Kujdesen për gjallesat dhe mjedisin që i rrethon.
 - Japin shpjegime elementare për dukuritë, proceset natyrore dhe zbatimet e thjeshta teknike.
 - Interpretojnë informacione të thjeshta, të dhëna në mënyrë vizuale dhe të shkruar.
 - Njohin teorikisht bazën materiale, proceset e punës dhe teknikat në realizmin e një punimi.
 - Vëzhgojnë elementet në një punim apo krijim.
 - Përshkruajnë dhe interpretojnë karakteristikat e punimit të kryer.

4. MATERIALE DIDAKTIKE

- Gërshërë me majë të rrumbullakët, të vogla dhe të mesme
- Vizore me gjatësi 20 cm.
- Trekëndësh
- Kompas të thjeshtë
- Furça për lëndën ngjitëse
- Letër vizatimi e bardhë, që nuk griset lehtë
- Letër me ngjyrë: e kuqe, e kaltër, e verdhë etj.
- Lapsa, lapsa të butë vizatimi
- Pastela (të paktën 8 ngjyra)
- Shenjues me ngjyra të ndryshme
- Bojëra, bojëra uji, tempera
- Ngjitës
- Argjilë, plastelinë
- Shkumësa me ngjyra
- Pineska
- Shirit mbulues
- Mjete për të punuar me argjil
- Gjilpëra për qepjen e copave, letrave etj.

Materiale për mësuesin:

- Kapëse letre
- Vizore
- Gërshërë me majë të mprehtë
- Hapëse vrimash në letër
- Makinë për lidhjen e letrës dhe kapëse
- Shirit mbulues
- Pineska
- Mjete për pastrim
- Sfungjer
- Copa të ndryshme
- Prerës letre
- Enë uji

